

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.03.2023*

23.03.2023  
Ora 11:04

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë “Lëvizja Bashkë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.”**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

- |  |   |
|--|---|
| <b>1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve</b> | <b>Z. Ilirjan Celibashi</b>                         |
| <b>2. Stafi KQZ:</b>                         | <b>Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj</b>                  |
| <b>Parti Politike:</b>                       | <b>“Lëvizja Bashkë”, Znj. V. Cipi, Z. R. Koçiaj</b> |
| <b>Të tjerë:</b>                             | <b>KRIIK</b>  |

**Z. I. Celibashi:** Mirëmëngjesi të gjithëve! Atëhere në seancën e sotme publike kemi në rend dite 3 çështje. Kemi shqyrtimin e kërkesës së Partisë “Lëvizja Bashkë”, për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Shqyrtimin e kërkesës së Koalicionit “Aleanca”, për tu regjisruar si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje, dhe pika e tretë ka të bëjë me rezultatet e verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Altin Losh Gjeloshaj, kandidat për deputet i listës shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët, për Qarkun Shkodër”. Këto kemi, atëhere mirë, fillojmë me rendin e parë të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë “Lëvizja Bashkë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Po, zoti Sekretar.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.03.2023*

**Z. Y. Merkaç:** Faleminderit! Partia “Lëvizja Bashkë” me në krye kryetarin e saj z. Arlind Qorri ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Bashkëngjitur me kërkesën është shoqëruar dhe dokumentacioni përkatës, shkurtimi i vendimit nr.4 datë 21.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Tiranë, në të cilin u zhvendos pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur, që Komisioni Qendror të Zgjedhjeve të regjistrojë partinë politike “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Referuar dhe nenit 64, të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me këtë nen. Për këto arsye i propozojmë Komisionerit ta regjistrojë partinë politike “Lëvizja Bashkë” në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Bashkëngjitur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Nga përfaqësuesit e subjektit politik kemi gjë?

**Përfaqësuesi i partisë:** Faleminderit, jo nuk kemi gjë.

**Z. I. Celibashi:** Atëhere vendosim regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar z. Arlind Qorri, me shkronjë nistore “Bashkë”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brënda 3 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

**Vendimi nr. 192**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.20.03.2023*

20.03.2023

Ora 14:03

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Koalicionit “Aleanca” (AL), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

**1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Z. Ilirjan Celibashi**

**2. Staf i KQZ:**

**Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**

**Znj. P. Doçaj**

**Parti Politike:**

**Të tjerë:**

**KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve, në seancën e sotme në rend dite kemi vetëm një çështje. Shqyrtimin e dokumentacionit që ka të bëjë me kërkesën për regjistrimin e Koalicionit Aleanca.

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Tre parti politike Aleanca Demokratike, Aleanca për Solidaritet, Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane kanë paraqitur kërkesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Bashkëlidhur është dokumentacioni i cili përbëhet nga një marrëveshje ku është caktuar sigla e koalicionit, shkronjat nistore dhe përfaqësuesi ligjor. Kërkesën nuk e kanë formalizuar nga ana formale me një kërkesë, kështu që i mungon dokumentacioni i plotë sipas nenit 65 të Kodit Zgjedhor, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.20.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, meqenëse dhe përfaqësues të partive politike që kanë paraqitur marrëveshjen për krijimin e këtij koalicioni nuk janë prezent dhe asnjë përfaqësues i të pretenduarve për krijimin e koalicionit, do t'i japim afat prej dy ditësh për plotësimin e dokumentacionit.

Mirë faleminderit seanca mbyllet ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



23.03.2023

Ora 11:07

### RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Koalicionit “Aleanca” (AL), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

- |  |   |
|--|---|
| <b>1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve</b> | <b>Z. Ilirjan Celibashi</b>                         |
| <b>2. Stafit KQZ:</b>                        | <b>Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj</b>                  |
| <b>Parti Politike:</b>                       | <b>“Lëvizja Bashkë”, Znj. V. Cipi, Z. R. Koçiaj</b> |
| <b>Të tjerë:</b>                             | <b>KRIIK</b>  |

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Tre parti politike: Aleanca Demokristiane, Aleanca për Drejtësi dhe Solidaritet, Aleanca për Drejtësi dhe Barazi Europiane kanë paraqitur kërkesën pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'u regjistruar si Koalicioni Zgjedhor për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore 14 maj 2023. Në seancën e kaluar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve u kthye për plotësim kërkesa pasi ka qene e paplotë. Duke i lënë një afat 48 orë brenda këtij afati, pas kalimit të këtij afati konstatohet se nuk është plotësuar ky afat, kështu që nuk është në përputhje me nenin 65 të Kodit Zgjedhor. Kërkoj të mos regjistrohet Koalicioni Aleanca (AL) si subjekt

Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.03.2023*


zgjedhor për të zgjedhur Organet e Qeverisjes Vendore të dates 14 maj 2023, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Dakord, atëhere vendosim:

- mosregjistrimin e Koalicionit Aleanca (AL) si subjekt zgjedhor pjesmarrës në zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe,
- kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda tre ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

**Vendimi nr. 193**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.03.2023*

**23.03.2023  
Ora 11:08**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Altin Losh Gjelošhaj, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët, Qarku Shkodër”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

- |  |   |
|--|---|
| <b>1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve</b> | <b>Z. Ilirjan Celibashi</b>                         |
| <b>2. Staf i KQZ:</b>                        | <b>Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj</b>                  |
| <b>Parti Politike:</b>                       | <b>“Lëvizja Bashkë”, Znj. V. Cipi, Z. R. Koçiaj</b> |
| <b>Të tjerë:</b>                             | <b>KRIIK</b>  |

*Z. I. Celibashi:* Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës.

*Z. Y. Merkaj:* Në zbatim të ligjit 138 të vitit 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve, për zgjedhjen dhe emërimin, për funksionet publike si dhe përpunimin e formularëve të vetdeklarimit për disa subjekte zgjedhore ndër këta subjekte të cilët edhe kandidatë për deputetë. Në zbatim të këtyre dispozitave zoti Altin Losh Gjelošhaj, Kandidat i propozuar për deputet, nga Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët”, Qarku Shkodër, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.03.2023*

me një numër unik 994. Pas verifikimeve paraprake u konstatua se kandidati nuk ishte në kushtet e ndalimit, dhe për këtë arsye Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.167 datë 18.03.2021, ka vendosur miratimin e listave shumëemërore të Koalicionit ABEOK. Nga verifikimi i të dhënave në formularët e vetdeklarimit, rezulton se subjekti vetdeklarues ka deklaruar në rubrikën “të dhënat mbi gjëndjen gjyqësore” të personit, se në datë 28.12.2017 është debuar nga shteti gjerman, me arsye refuzim hyrje, për të cilën i është vendosur gjobë. Pyetjes ‘A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?’, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me ‘Po’, ka deklaruar se ka jetuar në Gjermani për arsye punësimi në datën 27.12.2017. Nga konstatimet e mësipërme, bazuar në nenin 8 pika 1 të ligjit nr.138 të vitit 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ja kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila më datë 15.03.2023 ka sjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin për miratimin e rezultatit për verifikimin, për subjektin zotin Altin Losh Gjeloshaj. Zoti Altin Losh Gjeloshaj, kandidat i listës shumëemërore të Koalicionit ABEOK në zgjedhjet për Kuvënd të datës 25 prill 2021 Qarku Shkodër, nuk ka marrë mandatin e deputetit. Gjithashtu dhe subjekti zgjedhor Koalicioni ABEOK, nuk ka fituar asnjë mandate në Qarkun Shkodër. Në kushtet ku subjekti vetdeklarues nuk do të mund të marrë, të fitojë mandate në Qarkun Shkodër, për këtë legjislatur Komisioneri nuk mund të shpreh një vendimmarrje për çështjen shqyrtimi për sa kohë që ky subjekt nuk gëzon statusun e deputetit në asnjë rast, dhe për asnjë rrethanë, nuk mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është regjistruar, dhe procedura administrative e verifikimit të thelluar. Në analizë dhe në zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit nr. 138, si dhe nenet 90, 95 të Kodit të Proçedurave Administrative, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i proçedurave që ka filluar përpara ditës

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.03.2023*

së zgjedhjeve. Për këtë arsye I propozojmë Komisionerit ta përfundoj procedurën pa vendim .

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord ! Atëherë meqënëse ky subjekt zgjedhor në asnjë lloj rrethane nuk do të marri asnjë mandate. E përfundojmë shqyrtimin e thelluar për kandidatin e këtij subjekti pavendimarrje. Dakord, çështje tjetër nuk kemi? Faleminderit, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 194**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

